

**V E N D I M**  
**Nr. 63 Date 13.06. 2008**

**MBI APLIKIMIN E SHOQERISE “ERS - 08” SH.P.K PER LICENSIMIN NE**  
**AKTIVITETIN E NDERTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTEZIMIT TE**  
**CENTRALEVE ELEKTRIKE ME ERE DHE PRODHIMIN E ENERGJISE**  
**ELEKTRIKE NGA PARKU EOLIK KAVAJE**

Në mbështetje të neneve 9; 13 pikat 1, germa a, dhe 8, si dhe 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar; neneve 5, 13, pika 1 dhe 2, si dhe 14, te Rregullores per Procedurat e Licensimit, miratuar me Vendimin nr.24, date 04.04.2007, te Bordit te Komisionereve te ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 13.06.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “ERS – 08” Sh.p.k., per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjise elektrike, nga Parku eolik Kavaje,


**Konstatoi se:**

1. Fillimi i procedurave per shqyrtimin e aplikimit te ERS-08 sh.p.k, ka nisur me marrjen e vendimit nr. 29 date 04.03.2008.
2. Ligji nr. 9913, date 5.5.2008 ” Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk mund te kete fuqi prapavepruese per aplikimet e paraqitura para hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
3. Ne lidhje me ndertimin e ketij parku, shoqeria ERS- 08 sh.p.k aplikimin e saj per tu licensuar ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytezimit te centraleve elektrike me ere dhe prodhimin e energjise elektrike, e bazon studimin e prefizibilitetit ne te dhena historike te rregjistruara te eres, te matura ne lartesi te ndryshme nga nga ato ne te cilat do te punojne gjeneratorete.
4. Ligji per Sektorin e Energjise Elektrike parashikon ne nenin 15 autoritetin e ERE-s per vendosjen e kushteve te çdo license

Per sa konstatuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s,



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



**Vendosi:**

1. Licensimin e shoqërisë “ERS-08” shpk ne aktivitetin e ndertimit, instalimit dhe shfrytëzimit te centraleve elektrik me ere, si dhe te prodhimit te energjise elektrike nga Parku eolik Kavaje me kusht zbatimin perveç sa parashikuar ne licensen tip te miratuar nga Bordi i Komisionereve per aktivitetin e prodhimit te energjise elektrike, edhe te zbatimit te kushteve te meposhteme:
  - a. Kryerjen e një studimi fisibiliteti, që kushtezohet me instalimin e kullave vrojtuese për të eksperimentuar në kushtet reale dhe nxjerrjen e konkluzioneve definitive për projektin e zbatimit. Percaktimi në këtë studim i koston së prodhimit të energjisë elektrike. Ky studim të paraqitet në ERE brenda 12 muajve nga data e leshimit te licenses dhe perpara fillimit te zbatimit te punimeve. Për këtë shoqëria duhet të sjellë grafikun e rishikuar të punimeve.
  - b. Shoqëria “ERS-08” shpk duhet paraqesë pranë ERE-s, marrëveshjen e nenshkruar me OST sh.a., përpara fillimit të ndërtimit të objektit, ku të jenë të specifikuara detyrimet e ndërsjellta, që rrjedhin nga Kodi i Transmetimit.
  - c. Shoqëria “ERS-08” shpk, do të respektojë detyrimet e Shërbimit Publik që do të rrjedhin në zbatim të nenit 25, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar.
  - d. Koha e zbatimit e te gjithë projektit përfshirë dhe kolaudimin e veprës, duke ju referuar datës së leshimit të licencës të jetë 36 muaj.
  - e. Mospermbushja e pikave te mesiperme ne afatet e percaktuara e ben licensen te pavlefshme.
2. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet
3. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per Vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s**

**Bujar Nepravishta**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve

